

## NJOFTIM PËR POZICION VAKANT PUNE

<b>Emri i Punëdhënësit:</b>	Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit
<b>Pozicioni:</b>	Guidë pranë Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në sitin e Trashëgimisë Botërore të Butrintit, Shqipëri
<b>Vendi i Punës:</b>	Parku Kombëtar i Butrintit, Sarandë, Shqipëri
<b>Raporton Pranë:</b>	Menaxherit të Vizitorëve
<b>Lloji i punës:</b>	Me kohë të plotë

### Përshkrimi i Punës:

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit është në kërkim të një guide të pasionuar dhe me njohuri mbi historinë, kulturën dhe biodiversitetin e Parkut Kombëtar të Butrintit për të ofruar eksperiencë unike dhe informuese për vizitorët vendas dhe të huaj. Kandidati ideal do të ketë aftësi komunikuese të shkëlqyera, me aftësi për të përcjellë informacionin në mënyrë të qartë dhe interesante.

### Përgjegjësitë Kryesore:

- Të udhëheqë ture turistike në Parkun Kombëtar të Butrintit, duke ofruar informacion të detajuar mbi historinë, arkeologjinë dhe natyrën e zonës.
- Të sigurojë një përvojë cilësore për vizitorët, duke përdorur metoda interaktive dhe tërheqëse për shpjegimin e informacionit.
- Të përgjigjet në mënyrë profesionale dhe miqësore ndaj pyetjeve të turistëve.
- Të promovojë ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive kulturore dhe natyrore të parkut.
- Të ndihmojë në organizimin e grupeve dhe të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit ndjekin rregullat e sigurisë të parkut.
- Të bashkëpunojë me stafin e parkut për të ofruar shërbim të koordinuar dhe të kënaqshëm për vizitorët.

### Kualifikimet dhe Kërkesat:

- Diplomë universitare në Histori, Arkeologji, Turizëm, Biologji apo fusha të ngjashme (e preferueshme).
- Eksperiencë e mëparshme si guidë turistike ose në sektorin e turizmit.
- Njohuri të shkëlqyera mbi historinë, kulturën dhe biodiversitetin e Butrintit.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe tregimi të historive (storytelling).
- Njohuri të mira të gjuhës angleze (gjuhë të tjera janë avantazh).
- Aftësi për të punuar me grupe të ndryshme turistësh dhe të menaxhojë situata të ndryshme.
- Fleksibilitet për të punuar në ambiente të jashtme dhe orare fleksibël.
- Prioritet kanë guidat e licencuara.

**Kualifikimet e preferuara:**

- Eksperiencë në pozicion të ngjashëm.
- Çertifikime në gjuhë të huaja.

**Procesi i aplikimit:**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV dhe një letër motivuese në gjuhën shqipe që përshkruan përvojën e tyre përkatëse në [careers@bmf.al](mailto:careers@bmf.al) ose fizikisht pranë Parkut Kombëtar të Butrintit.

Aplikimet do të pranohen deri më datë 20/04/2026.